



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Ac.nr.5022/19**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Milena Djerić e Lumni Sallauka – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Y.G.D dhe Y.D, e përfaqësuar nga e ëma e saj Y.G.D, e të cilat i përfaqëson i autorizuari i tyre av.V.S nga Lipjani, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E...”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës se të paditues të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3090/14, të datës 05.04.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 09.02.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** si të pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E...”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3090/14, i datës 05.04.2019, në pikët I dhe II të tij, **VËRTETOHET**.

**II.** Në pikën III të tij, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3090/14, i datës 05.04.2019, mbetet **i pashqyrtuar**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me pikën I të aktgjykimit të ankimuar e ka miratuar pjesërisht kërkespadinë e paditëses Y.G.D dhe Y.D, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja ligjore Y.G.D, ashtu që është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve “E...”, me seli në Prishtinë, që paditëses Y.G.D, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 11.09.2013, t’ia paguaj shumat e specifikuara si me poshtë: për dëmin jo material, për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 1,500.00 euro, për shkak të frikës së përjetuar shumën prej 1,000.00 euro, ndërsa në emër të dëmit material për ushqimin e përforcuar shumen prej 70.00 euro; ndërsa paditëses Y.D, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentitn e komunikacionit të datës 11.09.2013, t’ia paguaj shumat dhe atë: për dëmin jo material, për

dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 1,500.00 euro, për shkak të frikës së përjetuar shumë prej 1,000.00 euro, ndërsa në emër të dëmit material për ushqimin e përforcuar shumë prej 70.00 euro. Me pikën II të aktgjykimit është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve “ E...”, me seli në Prishtinë, të paguaj shumat e gjykuara për paditëset si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për të paditëset e parë Y.G.D1 në shumë prej 2,570.00 euro (dy mijë e pesqind e shtatëdhjetë euro), aq edhe për paditëset e dytë Y.D, për të dy paditëset në shumë totale prej 5,140.00 euro (pesë mijë e njëqind e katërdhjetë euro). Krejt këto me kamatë prej 8% e cila do të llogaritet nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e gjere në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 1,244.50, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas marrjes - plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. Ndërsa në pikën III të aktgjykimit e ka refuzuar pjesën e kërkespadiës që ka të bëjë me shumat përtej shumës së gjykuar për të paditëset Y.G.D në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 900.00 euro, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 600.00 euro, ndërsa e ka refuzuar në tërsi kërkespadiën në emër të rehabilitimit në shumë 260.00 euro si dhe në emër të përkujdesjes së personit të huaj në shumë prej 900.00 euro, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 600.00 euro, ndërsa e ka refuzuar në tërësi kërkespadiën në emër të rehabilitimit në shumë prej 260.00 euro, si dhe në emër të përkujdesjes së personit të huaj shumë prej 85.00 euro, si të pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura dhe atë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë duke gjykuar shumë në pajtim me nenin 183.2 të LMD.

Paditëset nuk kanë paraqitur as ankesë, e as përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e të paditurës, është **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditëset me datën 14.11.2014, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kanë parashtruar padi për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditëseve Ylber Gashi Dulla dhe Y.D, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.3090/14, të datës 05.04.2019, me të cilin pjesërisht e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadiën e paditëseve sikurse në dispozitiv të tij. Në arsyetim të aktgjykimit është theksuar se në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese baza e kërkespadiës, po vetëm lartësia e saj. Gjykata e shkallës së parë për lartësinë e kërkesëpadiës është bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor dr.A.T - ortoped dhe dr.M.K – psikiatër. Bazën për kompensim gjykata e ka mbështetur në dispozitën ligjore nga neni 137, 154, 158 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (LMD), kurse lidhur me kërkesën për kamatë ka

vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenit 158 të LMD. Në raport me shpenzimet procedurale, gjykata ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e neneve 452 par.1 të LPK.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK.

Gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërisht të kërkesëpadisë së paditëseve, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit, pastaj rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit dhe rrjedhimisht përfundimin për vëllimin e kërkesës së aprovuar.

Gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qendrojnë pretendimet ankimore të të paditurës as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sipas gjykatës së shkallës së dytë gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe sa i përket pasojave që kanë pësuar paditëset për shkak të aksidentit në fjalë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së eksperteve mjeko ligjor dr.A.T - ortoped dhe dr.M.K - psikiatër, si dhe ekspertizës së komunikacionit të datës 04.12.2014 të mag.ing.traffik Asllan Pllana, si prova të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjykata e Apelit vlerëson se edhe në kuptim të dispozitave materialo – juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendje faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesat e aprovuara në shumat sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëseve dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të dëmtuarve – këtu paditëseve, satisfaksion që të njëjtat me këto mjete t'i riparojnë në një masë nevojat e tyre materiale si dhe zbutjen nga pasojat negative që u janë shkaktuar atyre me rastin e aksidentit, e që në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë kompensim apsolut të dëmit.

Edhe për kamatën gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur dhe atë në pajtim me dispozitat e nenit 378 dhe 382 të LMD së zbatueshme për këtë rast.

Drejtë është vendosur edhe në raport me shpenzimet procedurale të aprovuara, i cili vendim është nxjerr në përputhje më veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike

kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK.

Gjykata e Apelit ka vendosur sikurse në pikën II të këtij aktgjykimi, pasi që në raport me pikën III të aktgjykimit të ankimuar, nuk ka pasur pretendime ankimore.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit gjeti se ankesa e të paditurës është tërësisht e pabazuar, për çka edhe u vendos sikurse në diapozitiv të këtij aktgjykimi, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika (d), në lidhje me nenin 200 të LPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.5022/19, me datën 09.02.2021**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Valon Totaj**